

RAPPORTI VJETOR 2018

PËRMBAJTJA

✓ Mesazhi i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës	3
✓ Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm	4
✓ Vizioni, Misioni, Vlerat e Eurosig	5
✓ Sruturë qeverisë	6
✓ Eurosig nëpërmjet shifrave	9
✓ Disa të dhëna për Grupin Eurosig	10
✓ Ne jemi Eurosig	12
✓ Përgjegjësia sociale	21
✓ Promovimi i vlerave të Eurosig, çmime, vlerësime	25
✓ Pjesëmarrjet e Eurosig në kapitalin e shoqërive të tjera	27
✓ Lista e aksionarëve të Eurosig me pjesëmarrje influencuese të kapitalit	27
✓ Lista e administratorëve të Eurosig	27
✓ Monitorimi, administrimi dhe kontrolli i riskut që ndërmerr Eurosig	28
✓ Raporti i Auditimit të Brendshëm	30
✓ Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, treguesi i likuiditetit dhe treguesi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike	32
✓ Objektivat për vitin 2019	33
✓ Opinioni i Shoqërisë Audituese dhe Pasqyrat Financiare sipas SNRF	34

MESAZHI I KRYETARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS



Vasil PILO
KRYETARI I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS

*Të nderuar klientë, partnerë, miq e bashkëpunëtorë,
Të nderuar punonjës,*

Nëpërmjet këtij mesazhi përshëndetjeje, dëshiroj të ndaj përzemërsisht me Ju arritjet e Eurosig gjatë vitit 2018.

Në sajë të planifikimeve strategjike dhe politikave menaxheriale efektive që zbatuam, ne ia dolëm që të kapërcejmë me sukses sfidat e tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, duke treguar qëndrueshmëri, konsolidim dhe standarde të larta. Rezultatet e arritura nga Eurosig në vitin 2018 konfirmojnë gjithashtu se vendimet strategjike të ndërmarra më parë kanë luajtur një rol kyç që Grupi Eurosig të dalë me sukses nga një periudhë sfiduese transformimi. Kjo na jep garanci për realizimin me sukses të objektivave që kemi përcaktuar në nivel shoqërie dhe grupi.

Standardet e larta të arritura nga Eurosig janë provë e bashkëpunimit të suksesshëm që kemi përforcuar në vite me klientët dhe partnerët tanë, si dhe rezultat i përkushtimit maksimal të Menaxhimit të Lartë, Menaxhimit Operacional dhe të gjithë stafit të Eurosig.

Në udhëtimin tonë pesëmbëdhjetëvjeçar, kemi treguar se jemi gjithmonë me vizion, kemi identifikuar vazhdimisht mundësi të reja, duke ecur me kërkesat e tregut dhe nevojat e klientëve.

Por sfidat janë në rritje, veçanërisht në kushtet e ndikimeve jo të favorshme të faktorëve politikë, ekonomikë dhe socialë në Shqipëri dhe Kosovë, ku ne operojmë.


Në vitet në vazhdim është planifikuar rritje dhe konsolidim i mëtejshëm në tërësi dhe në linja specifike të biznesit. Manaxhimi efektiv i riskut dhe kapitalit do të mbeten shumë të rëndësishme në të ardhmen. Duke vlerësuar hapat e hedhur deri tani, theksoj se dixhitalizimi i shërbimeve të Eurosig mbetet një nga prioritetet kryesore.

Do të doja të përfitoja nga kjo mundësi për të falënderuar të gjithë punonjësit e Eurosig për punën e tyre dhe përpjekjet e vazhdueshme në vite dhe gjithashtu u kërkoj që të kenë të njëjtin përkushtim ndaj sfidave në të ardhmen.

Falënderim i veçantë për suksesin tonë u takon aksionarëve, klientëve dhe partnerëve të biznesit, për besimin që na kanë dhënë ndër vite.

Me besim në mbështetjen Tuaj të çmuar, Ju ftojme të udhëtojmë sëbashku edhe gjatë vitit 2019.

Vasil PILO
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës



MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



Dr. Xhevdet KOPANI
DREJTOR
I PËRGJITHSHËM

Të nderuar lexues,

Viti 2018 ka qenë një vit i suksesshëm për industrinë e sigurimeve, duke shënuar rritje të treguesve në tërësi. Gjatë këtij viti, tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 5,49%, në krahasim me vitin 2017, në numër kontratash rritja është 8,24%, kurse vlera e dëmeve të paguara u rrit me 26,4%. Dëmet vullnetare u rritën 1,04%, duke zënë 31,77% të të gjithë primit të sigurimeve të Jo-Jetës.

Për Shoqërinë Eurosiga, 2018-a ishte një vit i qëndrueshmërisë së rezultateve të viteve të fundit dhe konsolidimit të mëtejshëm të treguesve dhe performancës së saj. Shoqëria Eurosiga sh.a. arriti një volum primesh mbi 2,2 miliardë lekë, duke zënë 14,29% të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës. Dëmet patën një rritje prej 3,32%. Rritje të konsiderueshme patën dëmet e paguara të Fondit të Kompensimit duke arritur në 135 milionë lekë, ose 13,5% të të gjithë volumit të dëmeve të këtij fondi që ka paguar tregu i sigurimeve të Jo-Jetës. Sigurimet vullnetare arritën 25% të volumit të primeve.

Treguesit e arritur janë fryt i punës, përkushtimit, profesionalizmit të të gjithë punonjësve, agjentëve, ndërmjetësve, të bashkëpunëtorëve të mij, të cilët me këtë rast i falënderoj për gjithçka kanë bërë gjatë këtij viti për përmbushjen e objektivave strategjike dhe ato vjetore.

Gjithashtu, këta tregues pozitiv janë realizuar falë dhe kujdesit dhe mbështetjes së aksionarëve dhe Këshillit Mbikëqyrës.

Falënderim i veçantë është për të gjithë ata klientë që na besuan, por dhe për partnerët tanë ndërkombëtarë, risigurues, brokëra etj., të cilët dëshmuar partneritet, besnikëri dhe besueshmëri ndaj nesh.

Qëllimi i Shoqërisë Eurosiga ka qenë dhe mbetet puna në ekip, menaxhimi efikas, përgjegjshmëria e lartë në shërbimin ndaj klientit. Ofrimi i shërbimeve më të shpejta e cilësore për klientët, duke realizuar procesin e dixhitalizimit të shërbimeve, ofrimin online të tyre, reduktimin e kohës jo produktive të klientëve për marrjen e shërbimit dhe të dëmshpërblimit do të jenë drejtime në themel të punës tonë për të realizuar objektivat e vitit 2019.

Miqësisht
Dr. Xhevdet KOPANI

VIZIONI, MISIONI, VLERAT E EUROSIG

VIZIONI

Të qenit lider në fushën e sigurimeve, bazuar në standarde europiane, që orientohet nga performanca e shtuar, në përputhje me kërkesat e palëve të interesuara, duke u mbështetur në filozofinë e vlerave, profesionalizmit, bazueshmërisë ligjore, reflektimit ndaj kërkesave të klientit dhe fokusimit tek ai.

MISIONI

- të sigurojmë produkte, shërbime dhe aktivitete ndaj klientëve, duke përsosur shërbimin, cilësinë, profesionalizmin, etikën, duke funksionuar si një shoqëri financiare, me qëllim optimizimin e kërkesave të klientëve, rritjen e kapitalit financiar, rritjen e vlerës së aksioneve, duke i siguruar klientët për mbështetje në çdo kohë, për kompensim të plotë dhe të drejtë për dëmet;
- të ofrojmë shërbime sipas standardeve europiane, duke konsoliduar pozicionin e saj dhe duke garantuar emër e reputacion tek partnerët rajonalë, europianë e më gjerë;

c) të marrim reagime (feedback) nga klientët me forma e metoda bashkëkohore dhe reflektim të tyre, për të përmirësuar shërbimin.

VLERAT E SHOQËRISË

Shoqëria Eurosiga, tashmë ka një emër në industrinë e sigurimeve dhe përbën një vlerë të shtuar në këtë industri. Përvoja 15 vjeçare në fushën e sigurimeve, zgjerimi në tregun e sigurimeve në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, jo vetëm i ka konsoliduar këto vlera, por i ka bërë të qëndrueshme dhe që ndikojnë drejtpërdrejtë në vlerën e shoqërisë.

Filozofia e Eurosigit për orientimin ndaj klientit, përbën një qasje që mbart vlera për tani dhe në të ardhmen.

Shtrirja e Eurosiga në të gjithë vendin dhe burimet njerëzore të punësuar shtojnë vlerat dhe rritin mundësitë për suksese në vijimësi. Asetet humane po konsolidohen, duke i shërbyer sfidave të së ardhmes.


Pozicionimi dhe besueshmëria e arritur në industrinë e sigurimeve, përmirësimi i imazhit të Eurosiga, zgjerimi i rrjetit të shitjes së produkteve, investimet e bëra në teknologjinë e informacionit, kanë ardhur si rezultat i një drejtimi të suksesshëm menaxherial, pune të vazhdueshme nga një staf i kualifikuar, dinamik dhe profesionist i vërtetë në fushat që veprojnë.

Drejtesit dhe punonjësit e Eurosiga janë të vëmendshëm ndaj kërkesave të klientit, duke ju ofruar atyre produktet më favorite dhe këshillat më të mira.

Performimi i Eurosiga në raport me industrinë dhe historinë e saj, me rritje dhe konsolidim në tregun e sigurimeve, përbëjnë një vlerë që do të ndikojë pozitivisht në ecurinë e shoqërisë në të ardhmen.



STRUKTURA QEVERISËSE



QEVERISJA E EUROSIG

BURIMET NJERËZORE

Duke i konsideruar burimet njerëzore si një faktor të rëndësishëm dhe kapitalin intelektual për rritjen e biznesit tonë, Eurosiga investon sistematikisht në përzgjedhjen, trajnimin, vlerësimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e punonjësve. Aktualisht Eurosiga është e shtrirë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë me degë, agjenci dhe pika shitjeje e përfaqësimi. Shoqëri sigurimesh të Grupit Eurosiga performojnë me sukses dhe në Kosovë e Maqedoninë e Veriut.

Në Eurosiga, ne besojmë që rruga më e shpejtë për rritje është ekspozimi drejt sfidave të reja. Një shembull i mirë i këtij promovimi nga brenda është zhvillimi i eksperiencës sonë. Punonjësit e kualifikuar, të cilët po rriten në

shkollën e Eurosiga dhe kanë treguar një performancë të vazhdueshme, janë aktualisht menaxherë të strukturave qendrore dhe vendore në të gjithë Shqipërinë. Suksesi profesional i punonjësve të Eurosiga është i garantuar edhe përmes trajnimeve të vazhdueshme të menaxherëve dhe punonjësve të të gjitha strukturave. Gjatë vitit 2018, janë trajnuar në mënyrë të përqendruar dhjetëra punonjës, drejtues dhe specialistë të shitjes së degëve dhe agjencive, për zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosiga. Trajnime më specifike u janë ofruar punonjësve të rinj të rekrutuar dhe atyre që kalojnë në pozicione të reja pune. Punonjës të Eurosiga kanë përfituar edhe në trajnimet e ofruara nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

QEVERISJA E EUROSIG REALIZOHET NGA:

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

Aksionarët e shoqërisë Eurosiga janë:

Z. Kadri MORINAJ	→ 70,741 pikë përqindje pjesëmarrje.
Z. Xhevdet MORINA	→ 19,225 pikë përqindje pjesëmarrje.
EURO-ALBA-EA	→ 9,693 pikë përqindje pjesëmarrje.
Z. Ylli MERKAJ	→ 0,341 pikë përqindje pjesëmarrje.

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Këshilli Mbiqëqyrës, si organ qeverisës i Shoqërisë, mbiqëqyr punën menaxheriale dhe merr vendime për probleme të rëndësishme të nivelit strategjik, sipas përcaktimeve të akteve ligjore, nënligjore, rregullatore dhe akteve të brendshme të Eurosiga.

Anëtarët e Këshillit Mbiqëqyrës janë:

Z. Vasil PILO	- Kryetar
Z. Rexhep MEIDANI	- Anëtar
Z. Skënder MADANI	- Anëtar

KOMITETI I AUDITIMIT DHE MENAXHIMIT TË RISKUT

Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut ndihmon Këshillin Mbikëqyrës në përmbushjen e funksioneve të veta mbikëqyrëse kundrejt aksionarëve dhe palëve të interesit; shqyrton dhe vlerëson rregullisht politikën, strategjitë, kufijtë dhe proceset që kanë të bëjnë me menaxhimin e riskut në shoqërinë e sigurimit, si dhe jep rekomandime për Këshillin Mbikëqyrës në lidhje me miratimin e tyre, apo çdo ndryshim të tyre që gjykohej i përshtatshëm.

Gjatë 2018, Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut përbëhej nga:

Z. Halim BAKALLI	- Kryetar
Znj. Elda LASHI	- Anëtar
Prof. As. Dr. Zef GJETA	- Anëtar

Në ushtrimin e detyrave funksionale dhe përgjegjësi, Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut mbështetet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.

Përveç Komitetit të Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, në Eurosig funksionojnë edhe Komiteti i Investimeve, Komiteti i Risigurimit, Komiteti i Vlerësimit të Dëmeve dhe Grupi për Menaxhimin Strategjik Fushat e përgjegjësisë së tyre janë të përcaktuara në aktet e brendshme të Eurosig.

MENAXHIMI I LARTË

Menaxhimi i Lartë mbikëqyr dhe përgjigjet për menaxhimin e veprimtarive dhe performancën e të gjitha strukturave qendrore dhe vendore të Eurosig.

Menaxhimi i Lartë përbëhet nga:

Z. Xhevdet KOPANI	- Drejtor i Përgjithshëm
Znj. Anila IBRO	- Drejtor i Departamentit Ekonomik
Znj. Agena MEMA	- Drejtor i Departamentit të Sigurimeve dhe Risigurimeve
Z. Leonard HARIZI	- Drejtor i Departamentit të Dëmeve

MENAXHIMI OPERACIONAL

Menaxhimi Operacional përbëhet nga drejtues të drejtorive, sektorëve, njësive të tjera strukturore qendrore dhe degëve vendore, menaxhon dhe përgjigjet për performancën e njësive strukturore të Eurosig.



EUROSIG NËPËRMJET SHIFRAVE

Edhe për vitin 2018 shoqëria Eurosig ka performuar pozitivisht, duke treguar qëndrueshmëri, konsolidim dhe standarde të larta.

Disa nga treguesit kryesorë të vitit 2018, krahasuar me vitin 2017, janë:

- ❖ Në treguesin e volumit të primeve të shkruara bruto kemi ruajtur thuajse të njëjtin nivel, duke arritur në vlerën 2 247 109 000 lekë Renditemi në vendin e tretë me 14,29% të tregut.
- ❖ Numri i dëmeve të paguara u rrit me 0,6%, kurse volumi i dëmeve të paguara u rrit me 3,2%, duke arritur vlerën 583 299 000 lekë.
- ❖ Pësia specifike e volumit të sigurimeve vullnetare kundrejt totalit është 25%, duke u renditur në vendin e katërt.
- ❖ Volumi i primeve të shkruara bruto në Sigurimin Motorrik u rrit me 4,5%, kurse vlera e dëmeve të paguara për këto produkte u rrit me 20,66%.
- ❖ Në produktet MTPL e brendshme zotërojmë 14,24% të tregut duke u renditur në vendin e tretë; në Kartonin Jeshil zotërojmë 24,02% të tregut duke u renditur në vendin e dytë; në Kufitare zotërojmë 14,32% të tregut, duke u renditur në vendin e tretë; në sigurimin Kasko zotërojmë 11,56% të tregut, duke u renditur në vendin e katërt.
- ❖ Volumi i primeve të shkruara bruto në Sigurimin nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e tjera në Pronë u zvogëlua me 28%, kurse vlera e dëmeve të paguara për këto produkte u rrit me 44,52%.
- ❖ Pjesa e Eurosig ndaj totalit në Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit është 24,90%, duke u renditur në vendin e dytë. Vlera e dëmeve të paguara për Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit u zvogëlua me 36,19%, renditemi në vendin e dytë.
- ❖ Volumi i primeve të shkruara bruto në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim u zvogëlua me 18,76%, renditemi në vendin e tretë.
- ❖ Në Sigurimin e Sëmundjeve renditemi në vendin e dytë me 32,31% të tregut të Jo-Jetës.

DISA TË DHËNA PËR GRUPIN EUROSIG

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GRUPIT EUROSIG


Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në Rregulloren e AMF-së nr. 55, datë 26. 05. 2017, “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”, me vendim të Asamblesë së Ak-sionarëve nr. 15, datë 13. 11. 2017, është kri-juar Grupi i Sigurimit Eurosig. Në përbërje të këtij Grupi janë: Eurosig Shqipëri, shoqëri mëmë; INSIG Shqipëri, Eurosig Kosovë dhe Eurosig Maqedoni, shoqëri të kontrolluara nga Eurosig Shqipëri; dhe Dega e INSIG Kosovë, si Degë e INSIG Shqipëri.

Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar aktet e

brendshme të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e Grupit Eurosig, ku përmendim: vendimi nr. 17, datë 12. 12. 2017, “Për miratimin e organigramës dhe strukturës organizative të Grupit Eurosig”; Rregulloren nr. 18, datë 12. 12. 2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Grupit Eurosig”; “Kodin e Sjelljes dhe Etikës në Grupin Eurosig” nr. 19, datë 12. 12. 2017.

Me vendime të Këshillit Mbikëqyrës (maj 2018) janë emëruar dhe personat që mbulojnë funksionet përkatëse në Departamentin e Kontrollit dhe Kooordinimit.

Tabela organizative e Grupit Eurosig për vitin 2018



TREGUESIT KRYESORË PËR VITIN 2018

Nr.	Emërtimi	Volumi i primeve të shkruara bruto, në Euro	Pesha specifike ndaj totalit	Dëme të paguara, në Euro	Raporti Dëme të paguara/ Prime të realizuara
1.	Eurosig - Shqipëri	17 611 951	37,19%	4 576 945	26%
2.	Eurosig - Kosovë	9 787 371	20,67%	6 030 066	62%
3.	Insig - Shqipëri	8 570 143	18,10%	2 757 891	32%
4.	Insig - Kosovë	5 923 284	12,51%	3 064 856	52%
5.	Eurosig - Maqedoni e Veriut	5 458 385	11,53%	1 830 440	34%
Totali		47 351 134	100%	18 260 198	39%

NE JEMI EUROSIG

Shoqëria Aksionare Eurosrig është themeluar, më 16.07.2004, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, më 19.07.2004, me NUIS K41926801W. Drejtoria e Përgjithshme (struktura qendrore) e shoqërisë është në Tiranë, në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", Vila nr. 5.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet me ligjin nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe akte të tjera nënligjore dhe rregullatore të dala në zbatim të tij, si dhe mbikëqyrjet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Eurosrig udhëhiqet nga Statuti i Shoqërisë dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me Rregulloren e Brendshme "Për Organizimin dhe Funk-

sionimin e Shoqërisë Eurosrig sh.a." dhe një tërësi aktesh të brendshme.

Eurosrig, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë me 25 degë dhe 5 agjenci. Aktualisht në Eurosrig janë të punësuar 300 punonjës në nivel qendror dhe vendor. Në Drejtorinë e Përgjithshme ushtrojnë veprimtarinë Departamenti i Sigurimeve dhe Risigurimeve, Departamenti Ekonomik, Struktura e Trajtimin të Dëmeve, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Drejtoria e Administrimit të Shitjeve, Drejtoria e Financë-Kontabilitetit & Analizës, Njësia e Auditimit të Brendshëm etj.

AKTIVITETET KRYESORE TË EUROSIG PËRFSHIJNË:

Produktet e sigurimeve vullnetare:

- Sigurimi i Aksidenteve Personale,
- Sigurimi i Shëndetit dhe Sëmundjeve,
- Sigurimi Kasko,
- Sigurimi i Pasurisë (nga zjarri dhe forcat e natyrës),
- Sigurimet ndaj Dëmtimeve dhe Humbjeve të Tjera të Pasurisë,

- Sigurimi i Garancisë,
- Sigurimi i Mallrave në Transport,
- Sigurimi i Përgjegjësive të Anijeve dhe Mjeteve Lundruese,
- Sigurimi i Përgjegjësive të Përgjithshme (të të gjitha llojeve),
- Sigurimi i Bankave BBB&ECC;

Produktet e sigurimit të detyrueshëm:

- Sigurimi i Detyrueshem Motorrik për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta (DMT-PL),

- Certifikata Motorrike Ndërkombëtare e Sigurimit – Kartoni Jeshil,
- Sigurimet Kufitare.

Zgjerimi i rrjetit të shitjes, pozicionimi në tregun e sigurimeve me një rritje të ndjeshme dhe relativisht të shpejtë ka ardhur si rezultat i një pune të vazhdueshme të një stafi të kualifikuar, dinamik dhe profesionist të vërtetë në fushat që veprojnë. Drejtuesit dhe punonjësit e Eurosrig janë të vëmendshëm

ndaj kërkesave të klientit, duke ju ofruar atyre produktet më favorite dhe këshillat më të mira.

Eurosrig, në vitet e fundit, është karakterizuar si kompania me trendin më të lartë të rritjes në tregun e sigurimeve **në Shqipëri dhe rajon.**

SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Rr. "Papa Gjon Pali II", Vila nr. 5, Tiranë, Shqipëri

Xhevdet KOPANI

Drejtor i Përgjithshëm

✉ xhkopani@eurosrig.al
☎ +355 69 40 00 412

Anila IBRO

Drejtor

Departamenti Ekonomik & Operacional

✉ anibra@eurosrig.al
☎ +355 69 20 58 675

Agena MEMA

Drejtor

Departamenti i Sigurimeve & Risigurimeve

✉ amema@eurosrig.al
☎ +355 68 61 55 336

Leonard HARIZI

Drejtor

Drejtorja e Dëmeve Motorike & Vullnetare

✉ lharizi@eurosrig.al
☎ +355 69 80 66 121

Besim YMAJ

Drejtor

Drejtorja e Dëmeve Shëndetësore Motorike & Shëndetit në Udhëtim

✉ bymaj@eurosrig.al
☎ +355 67 20 77 624

Besmira SINANAJ

Drejtor

Drejtorja e Dëmeve të Aksidenteve, Sëmundjeve dhe Shëndetit

✉ bsinanaj@eurosrig.al
☎ +355 69 70 92 854

Krizelda THARTORI/ÇELA

Drejtor

Drejtorja Juridike

✉ kthartori@eurosrig.al
☎ +355 69 40 95 541

Veli HAKLAJ

Drejtor

Drejtorja e Menaxhimit të Riskut

✉ vhaklaj@eurosrig.al
☎ +355 69 85 38 593

Albiola TAKO

Shef

Drejtorja e Sigurimeve të Pronës, Përgjegjësi & Garancive

✉ atako@eurosrig.al
☎ +355 69 98 57 821

Edison THAÇI

Drejtor

Drejtorja e Administrimit të Shitjeve

✉ ethaci@eurosrig.al
☎ +355 69 70 74 532

Elda LASHI

Shef

Drejtoria e Financë-Kontabilitetit

✉ elashi@eurosig.al

☎ +355 69 37 72 964

Zamir GJATA

Shef

Sektori i Dëmeve të Kartonit Jeshil

✉ zgjata@eurosig.al

☎ +355 69 40 23 237

Fatjon SAJA

Shef

Sektori i Teknologjisë së Informacionit

✉ fsaja@eurosig.al

☎ +355 69 40 95 540

Areta ÇUKO

Aktuari i Autorizuar

✉ acuko@eurosig.al

☎ +355 67 22 99 970

Sekretaria

✉ info@eurosig.al

☎ +355 (0) 69 60 70 659

+355 (0) 42 223 841

DEGËT E EUROSIG

Dega TIRANA 1

Gani ÇUPI

Drejtor

✉ gcupi@eurosig.al

☎ +355 68 20 93 242 / +355 42272944

📍 Tiranë, Bulevardi "Bajram Curri", përballë Eksp. "Shqipëria Sot"

Dega TIRANA 4

Kolë KUKAJ

Drejtor

✉ kkukaj@eurosig.al

☎ +355 69 74 31 207

📍 Tiranë, Rr. "Asim Vokshi", përballë shkollës "Harry Fultz"

Dega TIRANA 2

Vladimir QILIMI

Drejtor

✉ dega.kamez@eurosig.al

☎ +355 69 40 80 033

📍 Kamëz, Bulevardi "Blu"

Dega TIRANA 5

Aishe THARTORI

Përfaqësuese Zyre

✉ jponari@eurosig.al

☎ +355 69 58 44 217

📍 Tiranë, Rruga "Stavro Vinjau", Nr 34, përballë Ambasadës Amerikane

Dega TIRANA 3

Sokol GASHI

Drejtor

✉ sgashi@eurosig.al

☎ +355 69 40 87 330

📍 Tiranë, Rr. e "Durrësit", përballë bllokut të ambasadave

Dega TROPOJË

Gazmend DOÇI

Përfaqësues

✉ dega.tropeje@eurosig.al

☎ +355 68 22 68 844

📍 Bajram Curri, Rr. "Azem Hajdari"

Dega SHKODËR 1

Siruan LISHI

Drejtor

✉ dega.shkoder@eurosig.al

☎ +355 (0) 22 44 592

📍 Shkodër, Rr. "2 Prilli", pranë Poliklinikës Qendrore

Dega SHKODËR 2

Gëzim ALIBALI

Drejtor

✉ dega.shkoder2@eurosig.al

☎ +355 694056455 / +355 672173111

📍 Shkodër, Lagjja "Vojo Kushi", Sheshi "Demokracia", para teatrit Migjeni

Dega LEZHË

Marie NDOJ

Përgjegjëse

✉ dega.lezhe@eurosig.al

☎ +355 21 54 917 / +355 69 54 46 692

📍 Lezhë, Lagjja Besëlidhja, P. 63

Dega LEZHË 2

Klodiana Ndoj

Përfaqësues

✉ dega.lezhe2@eurosig.al

☎ +355 69 57 87 445

📍 Lezhë, Rruga "Kosova", Pallati 76.

Dega KUKËS 1 & HAS

Shkëlzen MALAJ

Drejtor

✉ dega.kukes@eurosig.al

☎ +355 69 20 65 725

📍 Krumë, qendër

Dega KUKËS 2

Petrit PEPOSHI

Përgjegjëse

✉ dega.kukes2@eurosig.al

☎ +355 69 20 56 808

📍 Kukës, pranë stacionit KU-TR

Dega DIBËR

Asqeri PEPA

Drejtor

✉ dega.peshkopi@eurosig.al

☎ +355 68 2440810 / +355 69 4095550

📍 Peshkopi, Sheshi "Bajram Curri"

Dega MAT

Elison ÇUPI

Përfaqësues

✉ dega.mat@eurosig.al

☎ +355 69 20 80 038

📍 Burrel, Lagjja "Drita", Rr."Koke Malçi"

Dega ELBASAN 1

Adil KABILA

Drejtor

✉ dega.elbasan@eurosig.al

☎ +355 69 20 70 328

📍 Elbasan, përballë Postës Qendrore

Dega ELBASAN 2

Vladimir SULA

Drejtor

✉ dega.elbasan2@eurosig.al

☎ +355 69 20 35 463

📍 Elbasan, mbrapa Bashkisë

Dega DURRËS

Enkelejda COPA
Drejtor

☎ dega.durres@eurosig.al
☎ +355 69 20 35 462
📍 Durrës, Rr. "Admiral Abdi Mati"

Dega LUSHNJË

Albert ÇELA
Drejtor

☎ dega.lushnje@eurosig.al
☎ +355 (0) 35 22 57 34
📍 Lushnje, Bulevardi kryesor, pranë BKT-së

Dega KORÇË

Zana MANÇE
Drejtor

☎ dega.korce@eurosig.al
☎ +355 (0) 82 24 80 62
📍 Korçë, Bulevardi "Gjergj Kastrioti"

Dega BERAT

Bexhet ALIA
Drejtor

☎ dega.berat@eurosig.al
☎ +355 (0) 32 23 76 22
📍 Berat, Lagjja "30 Vjetori"

Dega POGRADEC

Elona KATIRAJ
Drejtor

☎ dega.pogradec@eurosig.al
☎ +355 83 22 3007 / +355 83 22 4791
📍 Pogradec, Lagjja 2, Rr. "Reshit Çollaku"

Dega VLORË 1

Fatmir HYSENI
Drejtor

☎ dega.vlore@eurosig.al
☎ +355 (0) 33 40 05 30
📍 Vlorë, Lagjja "Pavarësia"

Dega LIBRAZHD 1

Rezarta HUNÇI
Përgjegjës

☎ rhunci@eurosig.al
📍 Librazhd, Lagjja "Industriale"

Dega VLORË 2

Besnik MERKAJ
Drejtor

☎ dega.vlore2@eurosig.al
☎ +355 69 20 68 484
📍 Vlorë, Pallati i Ri , pranë Xhamisë

Dega FIER 1&2

Rustem HOXHA
Drejtor

☎ dega.fier@eurosig.al
☎ +355 69 31 87 111
📍 Fier, Bulevardi "Jakov Xoxa"

Dega GJIROKASTËR

Majlinda PETA
Drejtor

☎ dega.gjirokaster@eurosig.al
☎ +355 (0) 84 26 85 50
📍 Gjirokastër, Ish-blloku i furrave

Dega Fier 3

Mariol KONGJINI
Drejtor

☎ mkongjini@eurosig.al
☎ +355 69 29 49939 / +355 34 221666
📍 Fier, Lagjja "15 Tetori"

Dega SARANDË

Thanas QIRJAQI
Përgjegjës

☎ dega.sarande@eurosig.al
☎ +355 (0) 85 22 29 59
📍 Sarandë, Rr. "Onhezmi", pranë Elda

KLIENTËT E EUROSIG

Stafi i Eurosig sh.a. ofron shërbim të personalizuar për të gjithë klientët, përmes rekomandimeve për llojet e produkteve të sigurimit për të cilat individët ose bizneset mund të kenë nevojë, por edhe përmes krijimit të paketave të kombinuara të sigurimit, në përputhje me eksperiencën më të mirë ndërkombëtare. Produktet tona të sigurimit janë të një standardi ndërkombëtar dhe ofrojnë mbulim në sigurim për të gjithë klientët që mund të operojnë në fusha të ndryshme të ekonomisë, tregti apo industri. Stafi i Eurosig përmes një partneriteti me risigurues dhe brokera të mirënjohur ofron shërbim edhe klientë ndërkombëtarë, të cilët janë të përfshirë në Shqipëri në projekte të ndryshme.

Strukturat e Eurosig janë të fokusuar në klientelën e produkteve motorrike, me agjentë të përzgjedhur, dhe kërkojnë cilësi në ofrimin e shërbimit prej tyre, duke demonstruar aftësinë për të tërhequr klientelë të re dhe duke menaxhuar risqet në këtë nivel. Ne jemi gjithmonë në shërbim të klientëve tanë në çdo kohë, në komunikim të vazhdueshëm me ta dhe sfida jonë është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimit që ofrojmë në

treg, duke synuar të krijojmë standardet më të mira.

Kemi orientuar politika për zgjerim në produktet e sigurimit vullnetar të Pronës dhe Shëndetit, Sigurimit Kasko dhe Kartoni Jeshil. Klientela e bizneseve të vogla identifikohet nga ndërmjetësit dhe agjentët e besueshëm. Risqet më të mëdha përzgjedhen nga ndërveprimi i ndërmjetësve dhe specialistëve të shoqërisë të marrjes në sigurim.

Filozofia e kompanisë është e orientuar ndaj klientëve, duke synuar gjithmonë krijimin e një partneriteti afatgjatë me klientët tanë. Besimi që kemi krijuar tek klientët ka bërë që sot të numërojmë mes klientëve kompani të mëdha biznesi, për të cilat shërbimi është ofruar i personalizuar dhe në kohë reale. Stafi i mirëtrajnuar dhe aftësi të shkëlqyera teknike, por edhe komunikimi, përcjell të njëjtën filozofi biznesi tek klientët.

Sfida e Eurosig mbetet arritja e një portofoli më të balancuar të produkteve të sigurimit, duke rritur peshën që zënë në volumnin e primeve të shkruara sigurimet vullnetare si dhe zgjerimi i rrjetit të klientëve në zonat rurale.





PARTNERËT E EUROSIG

Detyrimet financiare ndaj klientëve garantohen jo vetëm nga kapacitetet tona teknike dhe financiare, por dhe nga tregu financiar ndërkombëtar. Pjesëmarrësit në kontratat e risigurimit që lidh EUROSIG janë shoqëri risigurimi që përmbushin standardet ndërkombëtare të pagesës së dëmeve dhe stabilitetit financiar, të listuara në bazën e vlerësimeve ndërkombëtare, në përputhshmëri dhe në zbatim të kritereve të përcaktuara në aktet ligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të EUROSIG.

Shoqëria EUROSIG ka investuar një kosto relativisht të lartë për risigurimet me kompani risigurimi prestigjioze, si Hannover Re, Polish Re, Trust Re, Generali Group, Partner Re, Scor Re, VIG Re për të garantuar financiarisht detyrimet e mundshme dhe përgjegjësitë ndaj klientëve, si në risqet e sigurimit të pronës ashtu dhe në ato të sigurimeve motorrike dhe të përgjegjësi. Grupi EUROSIG ka ruajtur prej disa vitesh dhe ka zg-

jeruar bashkëpunimin edhe me risigurues të tjerë, si Munich Re, Transatlantic Re, Atradius Re, Sava Re, Aspen Re dhe Swiss Re. Ne gjithashtu zhvillojmë marrëdhënie bashkëpunimi për risqet fakultative edhe me kompani të tjera risiguruese, gjithnjë duke u mbështetur në kriterin e vlerësimit financiar si dhe standardin e bashkëpunimit.

Marrëveshjet e Risigurimit të Pronës dhe Sigurimit të Detyrueshëm për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta, përveç garancisë financiare në pagesat e dëmeve të

mëdha, kanë krijuar një fleksibilitet dhe cilësi të veçantë shërbimi ndaj klientëve.

Shoqëria EUROSIG ka bashkëpunim edhe me broker risigurimesh, me të vetmin qëllim: plotësimin e kushteve teknike sa më të përshtatshme dhe profesionale. Brokerët e risigurimit që ne bashkëpunojmë janë: MARSH (brokleri më i madh në botë), AON (brokleri i dytë më i madh në botë), WILLIS, JLT Re, Ulysse Re etj.

KOMPANITË E RISIGURIMIT - GARANCI FINANCIARE DHE MBROJTJE PËR KLIENTIN

VLERËSIME PËR PARTNERËT E EUROSIG

hannover re

HANNOVER RE

Agjencitë e vlerësimit më të rëndësishme në industrinë e sigurimeve i kanë dhënë kompanisë së sigurimeve Hannover Re vlerësime shumë të forta për fuqinë financiare. Hannover Re, me një volum primesh bruto prej rreth 19.17 miliade Euro për vitin 2018, është kompania e katërt risiguruese më e madhe në botë. E themeluar në vitin 1966 dhe me një staf prej 3 300 punonjësish, kjo kompani kryen aktivitet në të gjitha linjat e Risigurimit të Jo-Jetës, Jetës dhe Shëndetit, duke qenë e pranishme në të gjitha kontinentet.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A+	Superior
S&P	AA-	Very strong



POLISH RE

Shoqëria e Risigurimit Polish Re (Polskie Towarzystwo Reasekuracji) është e vetmja kompani në Poloni e specializuar në mënyrë specifike në biznesin e Risigurimit, në ofrimin e risigurimit të kompanive të sigurimit duke marrë përsipër pjesën e të ardhurave të tyre, primet e sigurimit, në këmbim për pjesëmarrjen e mëvonshme në mbulimin e dëmeve. Kjo kompani ka hyrë në tregun e Risigurimit që nga shtatori 1996 dhe aktualisht operon në 40 vende të botës, me mbi 200 klientë. Polish Re është një risigurues lider dhe ka fituar besimin e klientëve në të gjitha shtetet e Europës Qendrore dhe Lindore.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A-	Stable



TRUST RE

Shoqëria e Risigurimit Trust Re në vitet e fundit ka shtuar prezencën e saj në shtetet e Europës Jugore dhe Juglindore duke qenë një partner i rëndësishëm edhe për Grupin Eurosig. Trust Re ka një kapital të autorizuar prej 500 milionë USD dhe kapital të paguar prej 250 milionë USD. Shoqëria Trust Re operon prej 25 vitesh në tregun e Risigurimeve duke mbuluar të gjitha linjat e biznesit me një orientim drejt linjave të reja të biznesit dhe inovacionit.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	B++	Good



GENERALI GROUP

Grupi "Generali" është një nga aktorët më të rëndësishëm në tregun e sigurimit global dhe financiar. E themeluar që në vitin 1831, në Trieste, karakterizohet që nga fillimi me një opinion të fortë ndërkombëtar dhe tani është e pranishme në më shumë se 60 vende të botës nëpërmjet 500 kompanive ndërkombëtare. "Generali" ka konsoliduar pozicionin e tij në mesin e operatorëve kryesor të sigurimit dhe risigurimit në botë, me aksione të ndjeshme në treg në Evropën Perëndimore - zona e saj kryesore e veprimtarisë - veçanërisht në Gjermani, Francë, Austri, Spanjë dhe Zvicër ndërsa vitin e kaluar është zgjeruar me blerjen e disa kompanive në zonën e Europës Juglindore dhe qendrore. Me kapital të paguar prej 1,57 miliardë Euro dhe volumin e Primeve Bruto prej 66.69 miliardë Euro për vitin 2018, Grupi "Generali" klasifikohet në listën e 25 Risigrueseve më të mëdhenj në botë.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A	Stable
Fitch	A-	Stable

VLERËSIMI I SHOQËRIVE TË TJERA RISIGURUESE

REINSURANCE COMPANY	RATE	
	S&P	A.M. BEST
PARTNER RE ZVICËR	A+	A
SCOR GLOBAL P&C DEUTSCHLAND	AA-	A+
SWISS RE	AA-	A+
R+V GERMANY	AA-	NR
VIG RE, CZECH REPUBLIC	A+	NR
ASPEN RE UK PER ZURICH BRANCH	A	A
GIC	NR	A-
NEW RE	AA-	A+

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Eurosig i kushton përgjegjësisë sociale një vëmendje shumë të madhe. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, z. Kadri Morinaj, Eurosig ka angazhuar burime njerëzore dhe financiare, të cilat janë në dispozicion të drejtpërdrejtë të shoqërisë dhe mjedisit ku Eurosig ushtron veprimtarinë e saj, por dhe më gjerë, mjedisit kulturor, artistik, mediatik etj. Një vëmendje të veçantë ka patur Eurosig edhe ndaj shtresave në nevojë.

Për vitin 2018, nga Eurosig dhe presidenti i Grupit Eurosrig, z. Kadri Morinaj, dha mbështetje financiare për:

- ❖ Filmin e suksesshëm dhe të realizuar mjaft mirë "Dashuria s'mjafton", ku, krahas aktorëve të mirënjohur Guljelm Radoja, Bruno Shllaku, Çun Lajçi, la gjurmë edhe aktrimi i Klark Morinaj, i cili tashmë është bërë pjesë e botës së artit.
- ❖ Institutin e Studimeve Historike "Lumo Skëndo" për botimin e vëllimit të dytë me vepra të përzgjedhura të Mit'hat Frashërit.
- ❖ Aktivitetet në kuadër të Ditës Kombëtare të Fëmijëve Jetimë, ku 200 fëmijë jetimë, të shoqëruar dhe nga figura të njohura të artit e kulturës, mbushën sallën e Parlamentit dhe diskutuan për problemet e tyre, si dhe u pritën nga Presidenti i Republikës, Z. Ilir Meta.
- ❖ Mbështetjen e botimit dhe promovimit të librit "Shikaj, vendlindja jonë", me autor Hasan Ahmetaj.
- ❖ Aktivitetin e zhvilluar në Tiranë për legjendën e muzikës shqiptare, Nexhmie Pagarusha, në 85-vjetorin e lindjes.
- ❖ Koncertin recital të këngëtarit të mirënjohur Bujar Qamili, që u mbajt më 20 maj 2018, në Pallatin e Kongreseve.
- ❖ Realizimin e bustit të Eqerem Çabejt, veper e skulptorit Hektor Dule, vendosur pranë Akademisë së Shkencave, në Tiranë.
- ❖ Edicionin e VII të Festivalit Ndërkombëtar "Different Trains Festival", 30 prill - 7 maj 2018, ku një grup instrumentistësh nga Shqipëria dhe vende të tjera të Evropës, luajtën për afro një javë në kryeqytet, pjesë të zgjedhura nga kompozitorët më të njohur botëror.
- ❖ Edicionin e radhës të Kompeticionit Ndërkombëtar të Fluturimit "Albania Open", që u zhvillua në qytetin e Vlorës, maj 2018.
- ❖ Mbështetjen e ekipit shqiptar për t'u mundësuar marrjen pjesë në Kampionatin Botëror të Rafting, ku përfaqësuan Shqipërinë në mënyrë dinjitoze.






- ❖ Organizimin dhe përfundimin me sukses të Kampionatit të 7-të Kombëtar Shqiptar, në *Korça Open Air*, të koordinuar nga Aeronautika Shqiptare.
- ❖ Veprimtari të Kryegjyshitës Botërore të Bektashinjve, në Tiranë.
- ❖ Konferencën e Tretë për Financën me temë: Prioritetet e Ekonomisë Shqiptare në Kuadër të Integritetit Rajonal dhe Global.
- ❖ Promovimin e vlerave dhe traditave shqiptare në festën tradicionale të “Plisit të Bardhë”, të Shoqatës “Bytyçi”.
- ❖ Forumin “Studentët për Qeverisjen e Mirë”, së bashku me Fondacionin Konrad Adenauer. Ky forum u është gjendur përkrah studentëve dhe ideve të tyre në zhvillimin e vendit; studentes me esenë më të mirë iu ofrua mundësia të ishte pjesë e stafit të Eurosigs, menjëherë pas përfundimit të studimeve.
- ❖ Trajnimin intensiv të një pjese të stafit të Eurosigs nga kompania risiguruese “Trust Re”, në Qipro, mbi procesin e marrjes në sigurim të kontratave fakultative dhe marrëveshjeve të risigurimit,

- tarifimin, analizat e riskut, katastrofat natyrore, si dhe impaktin në tregun e sigurimeve dhe risigurimeve.
- ❖ Bursa për një pjesë të stafit të Eurosigs, të cilët ndoqën studimet master profesional në degën e Menaxhimit në Sigurime, pranë Universitetit “Luarasi”, ku edhe janë diplomuar, me synimin që profesionalizmi të jetë simbol i Grupit Eurosigs.
- ❖ Bursa studimi master për dy prej studentëve më të mirë të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike në Universitetin Politeknik të Tiranës; dhe për dy studentë të ekselencës të Albanian University.
- ❖ Çmimin e parë për punimin më të mirë me temë “Shpërblimi i Sigurimit në Rastet e Sigurimit të Pronës”, dhënë studentit të masterit në Fakultetin i Drejtësisë, Enea Sheqi, gjatë Konferencës Kombëtare me titull “Edukimi Financiar” të organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- ❖ Zbukurimet dhe ndriçimin në qytetin e Pukës duke krijuar një atmosferë festive me rastin e festave të fundvitit.
- ❖ Pajisje zyrash për institucionet arsimore të Bashkisë së Fushë Arrëz, duke lehtësuar sadopak procesin e mësimdhënies.

VEPRIMTARI TË TJERA NË KUADËR TË PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE EDUKIMIT TË KONSUMATORIT:

- ❖ Grupi Eurosigs dhe presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, iu bashkuan kauzës për ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri, duke ndikuar në rritjen e vizibilitetit të Kanioneve të Osumit dhe lumit të Vjosës, si dhe duke ndihmuar më shumë të rinj të talentuar nga zona e Skraparit, Beratit dhe Përmetit. Për këtë u përcollën dhe falënderime të veçanta nga presidenti i Federatës Shqiptare të Rafting, Z. Zamo Spathara.
- ❖ Për kompanitë Eurosigs dhe INSIG, edukimi financiar dhe ndërgjegjësimi i popullatës, në veçanti i brezit të ri në lidhje me sigurimet, janë mision shumë i rëndësishëm. Për këtë arsye, në bashkëpunim me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë, Eurosigs dhe INSIG ishin pjesë e takimeve të zhvilluara me studentë e pedagogë të Universitetit të Durrësit, të Fakultetit Ekonomik në Elbasan, të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Dhjetëra studentëve të pranishëm në orët e hapura iu shpjegua rëndësia e sigurimeve, historia e tyre dhe vlera që kanë për njerëzit.
- ❖ Gjatë një takimi brezash në 25-vjetorin e hapjes së Fakultetit Ekonomik në Uni-

- versitetin “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër, Presidenti i Grupit Eurosigs, Z. Kadri Morinaj, mbajti një fjalim përshëndetës për auditorin dhe stafin e pedagogëve, ku evidentoi disa pika të rëndësishme lidhur me zhvillimin e tregut të sigurimeve në Shqipëri.
- ❖ Për të dytin vit rresht, Grupi Eurosigs ishte pjesë e Panairit të Karrierës në Universitetin “Epoka”, me synimin për të afruar në radhët e stafit më të mirë të studentëve. Në stendën e Eurosigs dhe INSIG, dhjetëra të rinj që përfundojnë studimet aplikuan për punë në pozicione të ndryshme dhe për intership.
- ❖ Eurosigs ishte pjesë e Panairit “International Tirana Trade Fair”, që hapi siparin në Pallatin e Kongreseve, ku njohu të gjithë të interesuarit me produktet e paketat më të favorshme të sigurimit, për individët, familjet, fëmijët, shëndetin, pronën, përgjegjësitë e deri tek mjetet motorrike.
- ❖ Në vizitën e tyre në ambientet e punës të shoqërive Eurosigs dhe Insig, një grup nxënësish të Kolegjit “Turgut Ozal”, Tiranë, u pritën dhe nga Presidenti i Grupit Eurosigs, Z. Kadri Morinaj, i cili i njohu me ecurinë e Eurosigs në vite.





VEPRIMITARI TË STAFIT TË EUROSIG

- ❖ Presidenti i Grupit Eurosrig, z. Kadri Morinaj, në shenjë falënderimi për punën e kryer gjatë vitit 2018, shtroi një darkë madhështore për stafin e subjekteve të Grupit. Ai u kujdes që kjo mbrëmje të kthehej në një spektakël, duke ftuar grupe dhe këngëtarë të njohur si Elita 5, Olen Cezari, Gëzim Nika, Fatmira Breçani, Lorik Cana, etj. dhe një grup valltarësh

profesionistë. Gjithashtu shprehu mirënjohjen për punën e shkëlqyer në rang Grupi, duke akorduar çmime speciale për secilën kompani në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

- ❖ Grupi EUROSIG për punonjëset femra organizoi festën e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në fshatin Razëm.



PROMOVIMI I VLERAVE TË EUROSIG, ÇMIME, VLERËSIME

Edhe viti 2018 u shoqërua me promovim vlerash, çmime dhe vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare:

- ❖ Presidenti i Grupit Eurosrig, Z. Kadri Morinaj, u nderua në shkurt 2018 nga Familja Mbretërore Spanjolle "Për kontributin e tij në fushën e biznesit dhe angazhimin e tij për promovimin e tolerancës fetare në Shqipëri". Në mbrëmjen gala të organizuar në Madrid, ku merrnin pjesë akademikë, aristokratë dhe pjestarë të familjes mbretërore spanjolle, konsuj dhe diplomatë, gjatë marrjes së çmimeve, biznesmeni Morinaj vuri në pah shanset që ofron Shqipëria për investimet e huaja.

rinaj, i cili është një nga përfaqësuesit e shquar në Shqipëri, por dhe në botë, një nga pionerët e kapitalizmit shqiptar, një kapitalizëm me fytyrë humane pikërisht për shkak të aktiviteteve që ai ka zhvilluar dhe në fushën sociale."

- ❖ Presidenti i Grupit Eurosrig, Z. Kadri Morinaj, si promotor i vlerave shqiptare anë e mbanë botës, ishte pjesë e grupit të pelegrinazhit të pritur nga Papa Françesku, të cilët u ftuan në Romë për të përkujtuar 550-vjetorin e vdekjes së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu.

- ❖ Në maj 2018, Eurosrig u vlerësua me çmim europian për praktikën më të mirë në biznes në vitin 2018 nga Organizata Europiane për Kërkimin e Cilësisë (ESOR). Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve në Bruksel, presidenti i Grupit Eurosrig, Z. Kadri Morinaj, e cilësoi çmimin si një vlerësim për standardet europiane që ka arritur biznesi shqiptar, por edhe si një ogur të mirë në prag të hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European.

- ❖ Në Paris, në edicionin e 42-të të ndarjes së çmimeve të më të mirëve në fusha të ndryshme, presidenti i Grupit Eurosrig, Z. Kadri Morinaj, u vlerësua me çmimin "The Best Awards", si biznesmen i suksesshëm në ndihmë të njerëzve në nevojë dhe gjithashtu në fushën e filantropisë.

- ❖ Me këtë rast, Z. Dritan Tola, ambasador i Shqipërisë në Francë, tha: "Këtë vit çmimi iu dha një shqiptari, Z. Kadri Mo-



- ❖ Për kontributin e dhënë në promovimin e vlerave kombëtare, Presidenti i Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, u nderua me titullin “Anëtar Nderi” nga Shoqata e Miqësisë dhe Bashkëpunimit Shqipëri - Itali, në qytetin e Laçit.
- ❖ “Mirënjohje speciale”, ishte çmimi i dhënë për Presidentin e Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, nga Shoqata Mbarëkombëtare “Bytyçi”, me rastin e 15-vjetorit të Festës së Plisit të Bardhë, organizuar më 26 gusht 2018.
- ❖ Për të dytin vit radhazi, Grupi Eurosig u vlerësua me Çmimin e Ekselencës në Biznes nga Awards Business Trend Albania 2018, në kategorinë e siguruesve. Çmimi “Diamond Price 2018” akorduar Eurosig u tërhoq nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Xhevdet Kopani, në një mbrëmje gala, ku ishin pjesëmarrëse kompanitë më të mëdha shqiptare në kategoritë respektive.
- ❖ Mes kompanive më të mëdha në Kosovë, që kontribuan në forcimin e shtetit në 10 vitet e Pavarësisë, është renditur dhe Kompania Eurosig. Në një

aktivitet të organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, më 13 shkurt në Prishtinë, EUROSIG Kosova, pjesë e Grupit Eurosig, mori nga Presidenti i Kosovës, Z. Hashim Thaçi, “Medaljen e Mirënjohjes” si një nga kontribuesit dhe tatimpaguesit më të mëdhenj dhe më të mirë në vend. Çmimi u tërhoq nga Presidenti i Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, i cili shprehu vlerësimin e tij për aktivitetin dhe falënderoi organizatorët dhe Presidentin Thaçi për vlerësimin e bërë ndaj kompanisë së tij.

- ❖ Redaksia online www.kohajone.com, pas një votimi prej 29 ditësh, shpalli presidentin e Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, si Njeriun e Vitit 2018 në Biznes.
- ❖ SEE NEWS e ka renditur Shoqërinë Eurosig për të disatin vit rresht, ndër 100 kompanitë më të mëdha në Europën Juglindore, përsa u përket të ardhurave financiare në industrinë e sigurimeve.
- ❖ Edhe në analizën e vitit 2018, referuar xhiros vjetore, kompania EUROSIG është renditur nga Revista “Monitor”, mes 200 bizneseve VIP.

PJESËMARRJET E EUROSIG NË KAPITALIN E SHOQËRIVE TË TJERA

Eurosig zotëron 100% të kapitalit të shoqërive të sigurimeve INSIG Jojeta-Shqipëri, EUROSIG-Kosovë, EUROSIG-Maqedoni dhe Degës së INSIG-Kosovë.

Eurosig është pjesëmarrëse në kapitalin e shoqërisë INSIG-Jeta me 10% të kapitalit. Gjithashtu, aksionarët e Eurosig janë pjesëmarrës në kapitalin e shoqërive të tjera, si më poshtë:

Nr.	Aksionarët	Shoqëria	%
1.	Kadri Morinaj	Bar Restaurant “Piazza” sh.p.k.	100%
2.	Xhevdet Morina	“Alb Univers” sh.p.k.	100%

LISTA E AKSIONARËVE TË EUROSIG ME PJESËMARRJE INFLUENCUESE TË KAPITALIT

Nr.	Aksionar influencues për vitin 2018	%
1.	Kadri Morinaj	70,74%

LISTA E ADMINISTRATORËVE TË EUROSIG

Administrator (Drejtor i Përgjithshëm) i EUROSIG është z. Xhevdet KOPANI, i cili nuk është pjesëmarrës në kapitalin e shoqërisë.

Koha Jone Shpall Njeriun e Vitit 2018



ERION VELIAJ
Politikani i Vitit 2018



KADRI MORINAJ
Biznesmeni i Vitit 2018



ALKETA VEJSIU
Moderatorja e Vitit 2018



MARIN MEMA
Gazetari i Vitit 2018

Veton Surroi mbron Bushatin dhe flet për ndikimin e Thaçit në largimin e ministrit

Emigrantët para Kryeministrit: Shqiptarë çohuni!

Njëzet kryesore të vitit që lamë pas në politikë, art dhe sport

Koha Jone
Ju nderon
Gjytnarë Vite e Re 2019



Kadri Morinaj
Biznesmeni i Vitit 2018

U lind në Natinë e Kadrit, shqiptar me krahinë e poshhtë, sipas ankës. Prej këtu raste të mirë mori dhe emrin, që duket se do t'i sillte fat gjatë gjithë jetës. Dëhet dale për zjeron me natyrë ambicioze. Kadri Morinaj, i ndërmarr në administratën biznesi të cilin rrugën e sipërmarrjes në vitin 1996, me kompaninë “Euro-Alba”. Me pasurinë e tij u bë me peshën e njërit prej ambicienëve më të njohura në Tiranë, deri në Restaurant “Piazza”. Nga viti 2000-2004, aktiviteti i tij u shtrirë në fushën bankare, si aksioner në disa banka private dhe në Shqipëri, ndërsa, me pasurinë e tij u bë një nga aksionerët e kompanisë telefonike T-Mobile. Në vitin 2004, Kadri Morinaj e zgjeron aktivitetin e tij në një fushë të re, pasi ambicia e tij ishte dhe sipërmarrja e sipërmeve. Ia arriti qëllimin duke bërë kompaninë e sigurimeve “Dukagjini”. Në vitin 2006, shoqëria “Dukagjini” e shpërndori emrin në EUROSIG, një kompani me kapital tërësisht shqiptar. Siç shprehet EUROSIG zuri një vend të fortit në tregun shqiptar të sigurimeve, duke u shtrirë në

plota shërbimesh dhe aktivitetesh, duke u renditur në kompanitë më prestigjioze. Ambicjet e Kadri Morinaj nuk mund të ndalojnë me këto. Kompania me trendin më të lartë të rritjes në Shqipëri nuk mund të rriste vetëm brenda kufijve të administratës të Shqipërisë, por duhet shtrirë edhe më gjërë në rajon, ku ka shqiptarë, por edhe më tej. Me iniciativën e tij gjatë vitit 2013, EUROSIG shtriu investimet edhe në Kosovë, për të zënë vendin e parë në tregun e sigurimeve. Ndërkohë, për të kaluarin vit rresht, EUROSIG mbeti kampioni si kompania me trendin më të lartë të rritjes në tregun e sigurimeve dhe me ritmin më të lartë të paguarve të dëmshme. Viti 2018 ishte viti i suksesit në sipërmarrjet dhe iniciativat ambicioze të presidentit Kadri Morinaj. Ndërsa rritet çdo ditë në bizneset e tij, ku sot janë të punësuar mbi 3000 punonjës në të gjithë rajonin ku të punësuar janë edhe njëzet me afërsisht të kësajmë, në maj të vitit 2018, Kadri Morinaj merrte si një tjetër ambicie të tij, duke e kurorëzuar me bërëjen e 100% të aksioneve të

Finançjeve dhe në vitin 2007, regjistrori shqiptar me fazon bejotëve Shmë Dragoi u bë kumbar i disit më të vogël të familjes, Klarkut. Këtu i kërkoj të famshmit nuk është rastësisht, i qytet me listave me emra, siç mund të bëjë çdo print për firmën e tij. Djali i vogël i familjes Morinaj ishte qytet i Klark, përderisi Gon

njerëzit e thjeshtë. Përkundrazi, si besimtar i dorës dhe qytet me shqiptarë të madh ai shkon sot një sërë veshesh bamirëse dhe filantropie. Ajo çfarë ka qenë më pikantja e që ka përfutur qëkënd që e ka parë e drigjaar është sponsorizimi i transportit të mjekëve në një firmë të vjetër, i cili,

nisi Mehmet Shahu, do të arrijte të bënte vllon e tij, dita dekada më vonë. Pro-fundamentit dhe sipërfaqes duket se janë sekretet i sekretit të biznesit të sipërmarrjes Kadri Morinaj.

eralt Amerikan Wesley Clark, komandant suprem i forcave të NATO-s në Europë, gjatë kohës së punës së tij në Kosovë për të qenë

mundësi ndihmës e Morinaj, fortësisht s'mund të jetë. Ndërkohë, zotërimi i tij për nëtin dhe kulturën janë edhe mbi 500 libra të sponsorizuara për botim të sh-

MONITORIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I RISKUT QË NDËRMERR EUROSIG

MENAXHIMI I RISKUT NË SHOQËRINË EUROSIG

Në zbatim të detyrimeve të akteve ligjore, rregullatore dhe akteve të brendshme, Eurosig ka implementuar një sistem të plotë të menaxhimit të riskut të shpërndarë në të gjitha nivelet e shoqërisë, në mënyrë që të mbështesin realizimin e objektivave strategjike dhe specifike.

Për rregullimin dhe normimin e punës së strukturave të Eurosig, në tërësi, si dhe në drejtim të pranimi dhe menaxhimit të riskut, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm kanë nxjerë një sërë aktesh të brendshme, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 52, datë 22.05.2015, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe aktet e rregullatore në zbatim të tij.

Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës, Menaxhimi i Lartë, Menaxhimi Operacional dhe çdo punonjës ka të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kufizimet e autoritetit të tij në aktet e brendshme të Eurosig, në lidhje me riskun dhe menaxhimin e tij. Kjo siguron dhe lidhjen e nevojshme midis detyrave që ka çdo punonjës dhe mënyrës se si i kryejnë këto detyra.

Duke marrë në konsideratë madhësinë e veprimtarisë së shoqërisë, kompleksitetin e saj dhe profilin e riskut, Eurosig ka krijuar Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, punonjësit e së cilës janë trajnuar nga AMF dhe zotërojnë kapacitetet e duhura profesionale për menaxhimin e riskut në shoqërinë e sigurimit. Punonjësit e kësaj drejtorie kanë autoritet të plotë për marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për ushtrimin e detyrave funksionale të përcaktuara në aktet rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosig.

Gjithashtu, Drejtorja e Menaxhimit të Riskut në Eurosig, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, komunikon me Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Auditimit & Menaxhimit të Riskut në lidhje me vlerësimin e ekspozimeve ndaj riskut dhe masat që duhen marrë për menaxhimin e tyre; vlerësimin e ndryshimit në profi-

lin e riskut; vlerësimin e ngjarjeve të riskut, si dhe përcaktimin e veprimeve të përshtatshme për ndreqje të situatës.

Mbështetur në Strategjinë pesëvjeçare të Eurosig 2016 - 2020 dhe Plan Biznesin 2018, u miratua Strategjia për Menaxhimin e Riskut 2018, në të cilën u përcaktuan:

- ❖ sistemi, politika, dhe parimet e menaxhimit të riskut;
- ❖ procesi i menaxhimit të riskut:
 - vendosja e objektivave,
 - kategoritë e riskut,
 - oreksi i riskut,
 - tolerancat e riskut,
 - identifikimi i riskut,
 - vlerësimi i riskut,
 - trajtimi i riskut,
 - monitorimi i menaxhimit të riskut;
- ❖ përgjegjësitë për menaxhimin e riskut;
- ❖ strategjitë e menaxhimit të riskut dhe
- ❖ dokumentimi dhe raportimi i çdo faze dhe veprimi të procesit të menaxhimit të riskut.

Eurosig aplikon metodologji dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, klasifikimin (kategorizimin), vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, në koherencë me kërkesat e AMF-së, të përcaktuara në manualin nr. 132, datë 31. 10. 2014, "Mbikëqyrja me fokus riskun".

Drejtorja për Menaxhimin e Riskut, në koordinim me strukturat qendrore dhe vendore të Eurosig, çdo vit identifikojnë risqet ndaj të cilëve është e ekspozuar veprimtaria e Eurosig dhe që përbëjnë kërcënim për realizimin e objektivave strategjike dhe specifike të shoqërisë. Këto risqe klasifikohen në shtatë kategoritë kryesore, si më poshtë:

1. Risku i Kreditit,
2. Risku i Tregut,
 - 2.1 Risku i Normës së Interesit,
 - 2.2 Risku i Këmbimit të Monedhës së Huaj,
3. Risku i Sigurimit,

3.1 Risku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit,

3.2 Risku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësië,

4. Risku Operacional,

5. Risku i Likuiditetit,

6. Risku Ligjor dhe Rregullator,

7. Risku Strategjik.

Bazuar dhe në vlerësime sasiore, sipas linjave të biznesit, në përfundim të procesit, bëhet një vlerësim cilësor i risqeve, duke i kategorizuar si **I ulët, Mesatar** ose **I lartë**.

Procesi vjetor i Menaxhimit të Riskut në Eurosig u finalizua me Raportin e Vetëvlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Paguese (nr. 3998/1,

datë 24. 05. 2019). Për hartimin e këtij Raporti përdoren teknikat analitike: analiza PESTEL, analiza SWOT, analiza e linjave të biznesit, analiza krahasuese e të dhënave, analiza e riskut etj. Versioni i plotë i Raportit, i klasifikuar "Sekret tregtar", u vjetë në dispozicion Presidentit, Këshillit Mbikëqyrës, Komitetit të Auditimit & Menaxhimit të Riskut dhe Menaxhimit të Lartë të Eurosig, kurse versioni i redaktuar u vjetë në dispozicion Menaxhimit Operacional të Eurosig.

Njëkohësisht është hartuar dhe Raporti Vjetor mbi Vlerësimin e Risqeve në Eurosig, i cili është dërguar në AMF me shkresën nr. 4112, datë 29. 05. 2019.

MENAXHIMI I RISKUT NË GRUPIN EUROSIG

Për menaxhimin e riskut në subjektet e Grupit Eurosig zbatohen kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe rregullatore përkatëse në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rregulla dhe procedura më specifike janë përcaktuar në aktet e brendshme të Grupit Eurosig dhe subjekteve përbërëse të grupit.

Në vendimin e Asamblesë së Aksionarëve nr. 15, datë 13. 11. 2017, "Për krijimin e Grupit Eurosig", është përcaktuar që:

- a) Kompetencat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Aksionarëve në nivel Grupi Eurosig ushtrohen nga Asambleja e Aksionarëve të Eurosig Shqipëri.
- b) Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës në nivel Grupi Eurosig ushtrohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Eurosig Shqipëri.
- c) Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut në nivel Grupi Eurosig ushtrohen nga Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut i Eurosig Shqipëri.
- d) Përgjegjësitë e Auditorit të Jashtëm në nivel Grupi Eurosig ushtrohen nga Auditori i Jashtëm i Eurosig Shqipëri.

Po kështu, për mirëqeverisjen në nivel Grupi janë krijuar dhe:

a) Bordi i Drejtorëve të Grupit Eurosig me këtë përbërje:

- ❖ Drejtori i Eurosig Shqipëri – Kryetar Bor-

di/Drejtor Ekzekutiv i Grupit Eurosig

- ❖ Drejtori i Eurosig Kosovë – anëtar
- ❖ Drejtori i Eurosig Maqedoni e Veriut – anëtar
- ❖ Drejtori i INSIG Shqipëri – anëtar
- ❖ Drejtori i INSIG Kosovë – anëtar.
- ❖ Drejtori i Departamentit të Kontrollit dhe Koordinimit – **anëtar**.

b) Departamenti i Kontrollit dhe Koordinimit me këtë përbërje:

- ❖ Drejtori i Departamentit të Kontrollit dhe Koordinimit,
- ❖ Koordinator për Grupin Eurosig,
- ❖ Auditori i Brendshëm për Grupin Eurosig,
- ❖ Drejtori i Menaxhimit të Riskut për Grupin Eurosig,
- ❖ Aktuari për Grupin Eurosig,
- ❖ Drejtori i Pajtuëshmërisë për Grupin Eurosig,
- ❖ Drejtori i Koordinimit dhe Raportimit Financiar për Grupin Eurosig dhe
- ❖ Drejtori për Marrjen në Sigurim dhe Risigurimin për Grupin Eurosig.

Personat përgjegjës që mbulojnë këto funksione janë emëruar në mbledhjen e datës 23 maj 2018 të Këshillit Mbikëqyrës, të Grupit Eurosig. Rregulla, procedura dhe metodologji për menaxhimin e riskut në Grupin Eurosig janë përcaktuar në pjesën e dytë të Strategjisë për Menaxhimin e Riskut në Shoqërinë Eurosig dhe Grupin Eurosig.

RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm për vitin 2018 në shoqërinë e sigurimeve “Eurosig sha” është zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, rregullores nr. 153, datë 23.12.2014, “Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit”, rregullores nr. 7, datë 30.01.2015, “Për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në Shoqërinë Eurosiga sha” dhe “Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2018” të shoqërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 12. 12. 2017.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi, gjatë gjithë vitit 2018, ka kontrolluar dhe audituar ecurinë e punës në fushat kryesore të veprimtarisë së Eurosiga. Pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm 2018, u shqyrtua dhe miratua dhe nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 2, datë 30 prill 2019. Raporti u është shpërndarë për njohje dhe zbatim të gjitha strukturave të Eurosiga.

GJETJE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Departamenti i Marrjes në Sigurim

- **Produktet Motorike** (përfshirë produktin Kasko). Në vitin 2018 sigurimet motorike rezultojnë me rritje rreth 4% të volumit të primeve të shkruara bruto, krahasuar me vitin 2017. Kjo për shkak të rritjes së nivelit të primeve të produktit TPL, pasi produktet e tjera (Karton Jeshil, Kufitare dhe Kasko) kanë rezultuar me rënie.

Niveli i shpenzimeve të marrjes në sigurim ka rënë krahasuar me një vit më parë, për shkak të mirëmenaxhimit të këtyre shpenzimeve. Është rritur kontrolli i ushtruar nga administrimi dhe si rezultat i kësaj janë zbatuar procedurat e marrjes në sigurim dhe shitjet janë rregjistruar në sistem nga të gjitha strukturat vendore të shoqërisë.

- **Produktet Vullnetare.** Pavarësisht objektivit të Eurosiga për zgjerimin e tregut të produkteve vullnetare, gjatë vitit 2018, rezulton se volumi i primeve të shkruara bruto të këtyre produkteve (pa përfshirë produktin Kasko) ka rënë me rreth 19%. Përveç produktit të

pronës, të gjitha produktet vullnetare rezultojnë me rënie krahasuar me një vit më parë. Si rezultat i kësaj duhet bërë një analizë e plotë ekonomike e situatës, me qëllim që të identifikohen faktorët që kanë ndikuar dhe të rishikohen mundësitë e zgjerimit të këtij tregu duke përdorur teknika e strategji të reja.

- **Produktet e sigurimit të Shëndetit Vullnetar dhe Aksidenteve Personale.** Në vitin 2018 ka pasur rënie të nivelit të volumit të primeve të shkruara bruto të këtyre produkteve krahasuar me vitin 2017. Pavarësisht nivelit të primeve, ka pasur një përmirësim të dukshëm në kushtet e kontratave të sigurimit, si dhe në procedurën e marrjes në sigurim. Përgjithësisht është vlerësuar saktë risku i klientëve dhe përcaktimi i primeve është bërë në përputhje me riskun. Si rezultat i kësaj ka pasur një përmirësim të dukshëm të raportit dëme/prime për kontrata specifike.

- **Produktet e sigurimit të Pronës.** Drejtoaria e produkteve të Pronës është organizuar si strukturë më vete dhe për vitin 2018 rezulton se ka pasur një ecuri të mirë; volumi i primeve të shkruara bruto u rrit me rreth 12% krahasuar me vitin 2017. Është rritur kontrolli i ushtruar nga kjo strukturë në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Administrimit të Shitjeve dhe si rezultat i kësaj ka pasur një përmirësim të dukshëm lidhur me zbatimin e procedurave të marrjes në sigurim. Janë organizuar disa trajnime si dhe është rritur bashkëpunimi

me strukturat vendore në funksion të identifikimit të mundësive të zgjerimit të tregut.

Theksojmë se të dhënat e shitjeve për të gjitha produktet e Eurosiga janë pasqyruar saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë kryer rakordimet përkatëse çdo muaj me strukturat e brendshme të Administrimit të Shitjeve dhe Financës. Raportimet periodike në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare janë kryer konform përcaktimeve në aktet rregullatore.

LINJA TË TJERA BIZNESI TË SHOQËRISË



Sektori i Teknologjisë së Informacionit, me mbështetjen e Menaxhimit të Lartë dhe Operacional, në bashkëpunim me kompaninë Edusoft, ka implementuar sistemin e ri E-Insurance, në të cilin janë implementuar moduli i shitjeve, moduli i dëmeve dhe moduli financiar. Gjatë vitit 2018 është integruar moduli i shitjeve me modulin financiar dhe të dhënat e shitjeve transferohen automatikisht. Gjatë vitit 2019, është parashikuar integrimi i mod-

ulit të dëmeve me modulin financiar dhe në këtë mënyrë do të arrihet që sistemi të funksionojë plotësisht dhe i gjithë informacioni (shitje, dëme, të dhëna financiare) do jetë i integruar në një sistem të vetëm.

Implementimi i sistemit të ri ka ndikuar në përmirësimin e procedurës së marrjes në sigurim, në uljen e riskut të mashtrim-it dhe gabimit njerëzor, si rezultat i transferimit automatik të të dhënave të shitjeve. Me vënien në funksion të plotë të këtij sistemi informatik, do arrihet që të sigurohet informacion i plotë i klientëve dhe në këtë mënyrë do vlerësohet saktë risku i tyre gjatë procedurës së marrjes në sigurim, i gjithë informacioni i nevojshëm do gjenerohet në kohë, si dhe do rritet niveli i sigurisë së ruajtjes së të dhënave.

Departamenti i Dëmeve funksionon i strukturuar sipas linjave të biznesit për produktet motorike dhe vullnetare. Për trajtimin e dëmeve të produkteve të shëndetit vullnetar dhe kartonit jeshil, janë krijuar struktura më vete, për shkak të natyrës specifike të këtyre produkteve.

Gjatë vitit 2018, sipas përcaktimeve në aktet e brendshme, janë trajtuar dhe dëmshpërblyer klientët brenda afateve të përcaktuara. Janë trajtuar me prioritet rastet e klientëve, të cilët nuk kanë qënë da-

kord me dëmshpërblimet, të cilat janë diskutuar në komisionet e posaçme me qëllim që t'u shërbehet sa më mirë klientëve dhe të kryhet vlerësim sa më i drejtë.

Drejtorja Juridike është angazhuar në ndjekjen e proceseve gjyqësore të shoqërisë Eurosig, si dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore të rasteve të Fondit të Kompenimit për çështje që trajtohen nga BSHS. Nga ana e juristëve janë ndjekur të gjitha proceset gjyqësore, ku është palë Eurosig, dhe përgjithësisht janë angazhuar dhe ekspertë të fushave përkatëse (mjek, vlerësues i dëmeve etj.) me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të interesave të shoqërisë. Përgjithësisht rezultatet e gjyqeve kanë qënë në favor të kompanisë, gjë që tregon punën e kujdesshme të bërë dhe nga punonjësit e strukturave të trajtimit të dëmeve, por dhe të linjave të biznesit të marrjes në sigurim.

Statistika. Të dhënat lidhur me shitjet, anulimet, kthimet, dëmtimet e policave janë të pasqyruara saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Të dhënat lidhur me praktikën e dëmeve janë pasqyruar saktë në database-in e Departamentit të Dëmeve, si dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Janë respektuar afatet e dërgimit të evidencave ndërmjet strukturave dhe në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

TREGUESI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT, TREGUESI I LIKUIDITETIT DHE TREGUESI I AKTIVEVE NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE

Vlerat e Treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, Treguesit të likuiditetit dhe Treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike mund t'i konsultoni në Raportin e shoqërisë audituese mbi pasqyrat financiare 2018 të shoqërisë, përgatitur sipas SNRF, pjesë e këtij raporti.

Menaxhimi i Riskut. Shoqëria Eurosig sha gjatë vitit 2018 ka hartuar "Strategjinë për Menaxhimin e Riskut", në të cilën janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e menaxhimit të riskut. Në këtë strategji është përcaktuar në mënyrë të plotë procesi i menaxhimit të riskut, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave të shoqërisë për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve.

Në përgjithësi ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara, si në drejtim të hartimit të procedurave, menaxhimit të shpenzimeve dhe administrimit të dokumentacionit. Janë kryer investigime, verifikime, vlerësime dhe kontrolle paraprake të dokumentacionit justifikues. Ky sistem me procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e risqeve që mbulojnë dhe menaxhojnë departamentet dhe njësitë e audituara.

Për periudhën në vazhdim, Njësia e Auditimit të Brendshëm do të kontrollojë dhe ndjekë rekomandimet e lëna në auditimet e kryera, si dhe njëkohësisht do të fokusohet me auditimin e veprimtarisë për vitin 2019. Për çdo pasaktësi, moszbatim urdhërash, ligjesh apo shkelje të konstatuara do të raportohet informacion i detajuar dhe do të jepen rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e punës në vazhdim.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2019

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

- 1) Rritja me 10%, krahasuar me vitin 2018, e volumit të primeve të shkruara bruto, duke garantuar rritje të kapitalit financiar, të performancës ekonomike, të aftësisë pague, të rezervave, si dhe përsosur sistemin e kontrollit të brendshëm dhe sistemin e menaxhimit të riskut.
- 2) Në fundin e vitit 2019, raporti i volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin vullnetar me volumen e primeve të shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm të jetë në masën 31% me 69%.
- 3) Shpenzimet për vitin 2019 të mbahen në nivelin 93% të të ardhurave.
- 4) Rritja e volumit të dëmeve të paguara duke synuar vlerësim të drejtë, pagesë të shpejtë, si dhe rritje deri në 28% të raportit të volumit të dëmeve të paguara me volumen e primeve të shkruara bruto, deri në fund të vitit 2019.
- 5) Projektimi dhe hedhja në treg e të paktën katër produkteve online (SHU, SHU Studenti, TPL, Kufitare, Kartoni Jeshil).
- 6) Zhvillimi i *site paralel* që do përdoret për menaxhimin e shoqërisë në rastin e katastrofave natyrore. Hartimi, miratimi dhe testimi i Planit të Vazhdueshmërisë së Biznesit në raste katastrofash.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE:

- 1) Segmentimi i klientëve, duke u përqendruar fort tek produktet vullnetare, nëpërmjet burimeve njerëzore me formimin e duhur profesional, kombinuar me një marketing bindës.
- 2) Zbatimi rigoroz i politikave dhe procedurave për marrjen në sigurim dhe risigurimin, me bazë riskun.
- 3) Implementimi i të gjitha moduleve të programit informatik të kompanisë EduSoft; ideimi dhe hedhja në treg e produkteve dhe paketave me produkte të reja; hedhja në treg e produkteve online; zbatimi i politikave për uljen e produkteve me humbje teknike.
- 4) Hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të punës në sistemin e ri informatik.
- 5) Trajnimi i burimeve njerëzore, i kombinuar me trajnime të nivelit të mesëm operacional edhe jashtë Shqipërisë.
- 6) Vlerësim të drejtë, të shpejtë dhe pagesë të dëmit brenda gjysmës së kohës të përcaktuar në rregullore.
- 7) Menaxhimi i kostove të shërbimeve mjekësore me tendencë ulje për vitin 2019, duke rishikuar dhe negociuar kushtet e marrëveshjeve me rrjetin spitalor.
- 8) Ndjekja e një politikë konservative të shpenzimeve në tërësi, veçanërisht të shpenzimeve të përgjithshme.
- 9) Mbajtja e një gjendjeje të shëndoshë financiare, duke siguruar një aftësi pague të qëndrueshme, si dhe aktive të mjaftueshme në mbulim.
- 10) Forcimi i auditimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.

RAPORTI I SHOQËRISË AUDITUESE DHE PASQYRAT FINANCIARE 2018 SIPAS SNRF

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Eurosig sh.a



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. Sami Frashëri, Kompleksi T.12, Shk. B
Floor 1, 10100
Tirana, Albania
T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 36 980
www.grantthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët dhe drejtimin e Grupit Eurosig Sh.a,

Opinion në Regjistrë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëngjitur të Grupit Eurosig Sh.a dhe Shoqërive të Kontrolluara prej tij ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare më 31 dhjetor 2018, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të anësorëve gjithëpërfshirës, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parash për vitin e mbylltur në atë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe të tjera shënime shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përkrahura në seksion e raportit tonë *Rezat për Opinione në Regjistrë*, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëngjitur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të konsoliduar të Grupit me datën 31 dhjetor 2018, dhe performancën financiare të konsoliduar dhe flukset e parash të konsoliduara për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Rezat për Opinione në Regjistrë

1. Modifikime të opinionit në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara.

- 1.1 Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare të Grupit Eurosig Sh.a përfshin emrin e miut (shënim 18) të njohur në konsolidim për vlerën 751,962 mijë lekë, i cili përshkruhet përkatësisht nga vlera prej 20,428 mijë lekë e emrit të miut të njohur në konsolidimin e aktiveve neto në datën e blerjes të Shoqërisë të Kontrolluar Eurosig Sh.a në Kosovë dhe nga vlera prej 731,535 mijë lekë të njohur në konsolidimin e aktiveve neto në datën e blerjes të Shoqërisë të Kontrolluar Insig Sh.a. Megjithatë ekzistojnë indikatorë për rritje në vlerë të emrit të miut më 31 dhjetor 2018, dhe 2017, Grupi nuk ka kryer ndonjë test për rritje në vlerë të emrit të miut. Rejdhimisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm për rritjen në vlerë të emrit të miut më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.
- 1.2 Grupi nuk ka kryer ndonjë vlerësim, në datën e blerjes, të aktiveve neto të Shoqërisë të Kontrolluar Insig Sh.a dhe Eurosig Sh.a në Kosovë si edhe në datën e shirjes së shoqërisë të kontrolluar Insig Jeti Sh.a. Rejdhimisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm për vlerën e drejtë të aktive dhe detyrimeve të shoqërive të kontrolluara, të njohura në konsolidim më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

1.3



- 1.4 Sikurse detajshet në shënimin shpjegues 3.5 *Përdorimi i shënjës dhe gjatës, rrethant e përshkruara në paragrafet përkatëse të parimit të vijimitshëm të Eurosig Sh.a në Shqipëri, Insig Sh.a në Shqipëri, Insig Sh.a në Kosovë, Eurosig AD dhe Eurosig Sh.a në Kosovë, tregojnë ekzistencën e një pasigurie materiale për vijimitshëm e bilancit të Grupit. Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit nuk përfshijnë ndonjë korigjim të mundshëm nga kjo pasiguri.*
2. Modifikime të opinionit në lidhje me pasqyrat financiare të Shoqërisë mëmë Eurosig Sh.a të cilat kanë efekt në pasqyrat e konsoliduara.
- 2.1 Pasqyra individuale e poziticionit financiar të Shoqërisë mëmë përmban të ardhën nga sigurimi dhe të tjera në vlerë neto prej 187,513 (2017: 222,404 mijë Lek). Gjithashtu, gjatë vitit 2018 Shoqëria ka miratuar parapagimet ndaj punonjëseve që veprojnë si agjente të Shoqërisë. Këto parapagime nuk i janë kthyer Shoqërisë deri në datën e këtij raporti. Megjithatë ekzistonin të dhëna objektive zhvlerësimi për këto tepërime në datën e raportimit, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit 39 Instrumentat Financiarë, Njohja dhe Matja. Rejdhimisht, ne nuk mund të përcaktojmë nëse kishte nevojë për rregullime të provizionit të të ardhënashmeve nga sigurimi dhe të tjera më 31 dhjetor 2018.
- 2.2 Pasqyra individuale e poziticionit financiar përmban aktive të tjera të cilat përfshijnë të ardhën nga sigurimi dhe të tjera në vlerë prej 453,305 mijë Lekë. Eurosig Sh.a me anë të kontratës së shërbimit, datë 10 maj 2017, ka shitur 90% të aksioneve që zotëronte në Insig Jeti Sh.a, respektivisht në masën 45% të aksioneve të Z. Samir Mane dhe 45% të aksioneve të Z. Shëfqet Kastrioti për vlerën totale prej 473,305 mijë Lek (3,500,000 Euro). Sipas termave të kësaj kontrate shuma prej 453,305 mijë Lekë duhet të ardhshin brenda një afati prej 24 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Deri në datën e këtij raporti kjo shumë nuk është ardhur. Pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara nuk përmblajnë ndonjë rregullim përta i përket kësaj çështje. Megjithatë ekzistonin të dhëna objektive zhvlerësimi për këto tepërime në datën e raportimit, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit 39 Instrumentat Financiarë, Njohja dhe Matja. Rejdhimisht, ne nuk mund të përcaktojmë nëse kishte nevojë për rregullime të aktiveve të tjera më 31 dhjetor 2018.
- 2.3 Shoqëria mëmë ka blerë dhe më pas rivlerësuar ndërtuesat gjatë vitit 2017. Vlera e drejtë dhe e rikuperueshme e ndërtuesave është përcaktuar nga një vlerësues i jashtëm personash i cili ka përdorur metodën e krahasimit për vlerësimin e ndërtuesave. Ne nuk mund të merremë evidencë të përshatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur në vlerësimin me bazën e krahasueshmërisë të kryer nga Shoqëria për përcaktimin e vlerës së drejtë të ndërtuesave. Si rejdhim, ne nuk mund të merremë sigurinë e mjaftueshme dhe të duhur për të përcaktuar nëse ka nevojë për rregullime në lidhje me vlerën e rikuperueshme të investimeve në ndërtues dhe pamti të paluajtshme në pasqyrën e poziticionit financiar të Shoqërisë Mëme dhe Grupit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.
- 2.4 Pasqyra individuale e poziticionit financiar të Shoqërisë mëmë më 31 dhjetor 2018, përmban Investime në Shoqëri të Kontrolluara në vlerën prej 2,670,990 mijë Lek e cila përshkruhet nga kosto për investimin në Insig Sh.a dhe Eurosig Sh.a Kosovë në vlerat 1,852,142 mijë Lek dhe 818,868 mijë Lek, respektivisht. Banka Qendrore e Kosovës më datë 26 prill 2019 ka revokuar licencën e Insig Kosovë, degë e shoqërisë së kontrolluar Insig Sh.a, ka njëzërisht hapjen e procedurës së likuidimit të detyrueshëm si edhe ka caktuar një likuidator. Kapitali neto i Insig Dega Kosovë më 31 dhjetor 2018 paraqitet në vlerë negative prej 516,768 mijë Lek (4,187,067 Euro). Gjithashtu, kapitali neto i Eurosig Sh.a Kosovë, paraqitet në vlerë negative prej 60,309 mijë Lek (488 652 Euro). Megjithatë ekzistonin tregues objektive zhvlerësimi për investimet në Shoqëritë e kontrolluara, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit 39 Instrumentat Financiarë. Rejdhimisht, ne nuk mund të përcaktojmë nëse kishte nevojë për rregullime të investimeve në Shoqëri të Kontrolluara në pasqyrat individuale të Eurosig Sh.a si edhe për vlerën e drejtë të aktiveve neto të Shoqërive të Kontrolluara në pasqyrat e konsoliduara më 31 dhjetor 2018.



3. Modifikime të opinionit në lidhje me pasqyrat financiare të Shoqërisë së Kontrolluar Eurosig Sh.a në Kosovë, të cilat kanë efekt në pasqyrat e konsoliduara.
